



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Komisioni Qendror i Zgjedhjeve
Centralna Izborna Komisija
Central Election Commission



Njësia e Prokurimit/Jedinica za Nabavke/Procurement Unit

KONTRATË E NEGOCIUAR E KUOTIMIT TË ÇMIMIT – FURNIZIM

KUSHTET & ANEKSET E NDËRLIDHURA

PIESA I E KONTRATËS:

Sekretariati i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (në vazhdim "Autoriteti Kontraktues"), në njërën anë; dhe

OE: Cetus d.d, Copova 24, 3000, Celje / Slloveni me numër fiskal SI24635812, përfaqësia e autorizuar Cetkos L.L.C., Prizren / Kosovë, (në vazhdim "Kontraktuesi") më numër të biznesit 70797348, në anën tjetër, janë pajtuar të lidhin një kontratë publike për ofrimin e furnizimeve.

"Shtypja, paketimi dhe transporti i fletëvotimeve për Zgjedhjet e Jashtëzakonshme për Kryetar të Komunave Lepasaviq, Zubin Potok, Zveçan dhe Mitrovicë e Veriut" me numër Identifikues e-prokurimit 320-19-2653-1-3-5 dhe Nr. i brendshëm 320/19/009/135.

Neni 1 Lënda

1.1 Lënda e kontratës do të jetë "Shtypja, paketimi dhe transporti i fletëvotimeve për Zgjedhjet e Jashtëzakonshme për Kryetar të Komunave Lepasaviq, Zubin Potok, Zveçan dhe Mitrovicë e Veriut" me numër Identifikues e-prokurimit 320/19/2653/135 dhe Nr. i brendshëm 320/19/009/135.

1.2 Kontrata hynë në fuqi me nënshkrimin e kontratës dhe përfundon më: 31.07.2019.

1.3 Afati kohor i performances nuk mund të jetë më shumë se 10 ditë nga data e marrjes së urdhërësës.

1.4 Vendi kryerjes së furnizimeve do të jetë: Rr. Migjeni nr. 21, SKQZ-Prishtinë.

1.5 Incotermi i aplikueshëm do të jetë DDP¹ (Detyra e Dërguar e Paguar).

¹ DDP – Detyra e Dërguar e Paguar- Incoterms 2010 Oda Ekonomike Ndërkombëtare

Kontratë e negociuar e Kuotimit të Çmimit: "Shtypja, paketimi dhe transporti i fletëvotimeve për Zgjedhjet e Jashtëzakonshme për Kryetar të Komunave Lepasaviq, Zubin Potok, Zveçan dhe Mitrovicë e Veriut" me numër Identifikues të e-prokurimit 320-19-2653-1-3-5 dhe Nr. të brendshëm 320/19/009/135

Neni 2 Ligji i aplikueshëm

2.1 Ligji i zbatueshëm do të jetë sipas Nenit 40 të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092 Për çështjet që nuk mbulohen me dispozita të kontratës, zbatohen ligjet në fuqi në Kosovë. Juridiksioni do të jetë gjykata përkatëse në Prishtinë.

Neni 3 Çmimi

3.1 Çmimi total i kontratës do të jetë: 5.974,00 € Pesëmijë e nëntëqind e shtatëdhjetë e katër Euro e 00/100.

Shtojcë oferta financiar e datës 02.05.2019.

3.1.1. Autoriteti Kontraktues nuk merr përgjegjësi për pagesën e shërbimeve, të cilat nuk kanë arritur që të realizohen për shkak të kalimit të afatit të tyre.

3.1.2. Do të paguhet vetëm aktivitetet të cilat realizohen në bazë të listës së çmimeve, të bashkangjitura kësaj kontrate.

3.2 Çmimi i përmendur në Nenin 3.1, pikat 1 dhe 2 më sipër duhet të jetë e vetmja pagesë që Autoriteti Kontraktues i ka borxh Operatorit Ekonomik sipas kontratës. Ai duhet të jetë i prerë dhe të mos i nënshtrohet ndryshimeve gjatë ekzekutimit të kontratës (në përjashtim të çmimeve të atyre artikujve që i nënshtrohen ndryshimit të çmimit sipas berzës përkatëse, nëse aplikohet).

Neni 4 Pagesat

4.1 Pagesa do të bëhet në Euro.

Autoriteti Kontraktues do të paguaj shumën totale të pagesës pas pranimit të tërë dërgesës.

4.2 Pagesat e detyrimeve sipas një fature të lëshuar nga Operatori Ekonomik duhet të paguhet brenda jo më shumë se 30 ditësh nga data në të cilën kërkesa e pranueshme për pagesë është regjistruar nga departamenti përkatës. Data e pagesës do të jetë data në të cilën debitet llogaria e institucionit. Kërkesa për pagesë nuk do të jetë e pranueshme nëse nuk plotësohen një ose më shumë nga kërkesat thelbësore.

Neni 5 Marrëveshjet lidhur me tatimin dhe doganën

5.1 Operatori Ekonomik është përgjegjës për të gjitha detyrimet dhe taksat në përputhje me Ligjin e Republikës së Kosovës.

5.2 Të gjitha taksat dhe detyrat e tjera doganore konsiderohen se janë të përfshira në çmimin e kontratës.

Neni 6 Kualiteti

6.1 Kualiteti i shërbimeve duhet në të gjitha aspektet të plotësojë specifikimet teknike të parashtruara në Dosjen e Tenderit.

Kontratë e negociuar e Kuotimit të Çmimit: "Shtypja, paketimi dhe transporti i fletëvotimeve për Zgjedhjet e Jashtëzakonshme për Kryetar të Komunave Leposaviq, Zubin Potok, Zveçan dhe Mitrovicë e Veriut" me numër Identifikues të e-prokurimit 320-19-2653-1-3-5 dhe Nr. të brendshëm 320/19/009/135

Neni 7 Garancioni

7.1 Garancioni do të mbetet valid për muaj, pas pranimit të furnizimit (Nuk kërkohet Garancion për këtë furnizim).

Neni 8 Vonesat në ekzekutim

8.1 Nëse Operatori Ekonomik me përgjegjësinë e tij nuk arrin [t'i dorëzojë ndonjë ose të gjitha mallrat] [të realizojë ndonjë ose të gjitha shërbimet] [te kryej ndonjë ose të gjitha punët] brenda limiteve kohore të specifikuara në kontratë, Autoriteti Kontraktues, pa njoftim zyrtar dhe pa paragjykim ndaj kompensimeve tjera të tij sipas kontratës, do të ketë të drejtë, për secilën ditë që kalon ndërmjet skadimit të periudhës së kontratës dhe datës aktuale të përfundimit, t'i marrë dëmet e likuiduara të barabarta me 0,25% në ditë të vlerës së [furnizimeve] [punëve] [shërbimeve] të pa dorëzuara deri në një maksimum prej 10 % të vlerës totale të kontratës.

Neni 9 Inspektimi dhe testimi

9.1 Autoriteti kontraktues do të ketë të drejtë që herë pas here të inspektojë, kontrollojë, masë dhe testojë komponentët, materialet, dhe mjeshhtërinë, dhe të kontrollojë përparimin e përgatitjes, fabrikimit apo prodhimit të çfarëdo artikulli që përgatitet, fabrikohet ose prodhohet për t'u dorëzuar sipas kontratës, në mënyrë që të përcaktojë nëse komponentët, materialet dhe mjeshhtëria kanë cilësinë dhe sasinë e kërkuar.

Neni 10 Nën-kontraktimi

10.1 Një nënkontratë do të jetë e vlefshme vetëm nëse është një marrëveshje me shkrim me të cilin Operatori Ekonomik i beson kryerjen e një pjese të kontratës së tij një pale të tretë. Operatori Ekonomik nuk duhet të nënkontrakttojë pa autorizim paraprak me shkrim nga Autoriteti Kontraktues. Autoriteti Kontraktues do të njoftojë Operatorin Ekonomik për vendimin e tij brenda 5 ditëve nga marrja e njoftimit, duke i paraqitur arsyet e veta nëse nuk lëshohet autorizimi.

Neni 11 Ndërprerja e Kontratës nga Autoriteti kontraktues

11.1 Autoriteti kontraktues mundet që, pasi t'i japë Operatorit Ekonomik shtatë ditë paralajmërim, ta ndërpresë kontratën në ndonjërin nga rastet në vijim: a) Kur operatori ekonomik nuk arrin t'i realizoj obligimet e veta sipas kontratës; b) Dështon në ekzekutimin e kontratës në afatin e caktuar; c). Refuzon urdhrat administrativ të autoritetit kontraktues; d) Ia jep dikujt kontratën apo nënkontratën pa autorizim nga autoriteti kontraktues; e). Falimenton; f). Është dënuar nga një gjykatë për një shkelje që ka të bëjë me sjellje profesionale, përmes një gjykimi që ka fuqinë e *res-judicata*; g) Operatori ekonomik i është nënshtruar një gjykimi që ka forcën e *res judicata* për mashtrim, korrupsion, përfshirje në ndonjë organizatë kriminale ose ndonjë aktivitet tjetër ilegal që i dëmton interesat e përgjithshme financiare; h) shfaqet ndonjë paafësi tjetër ligjore që i pengon realizimit të kontratës.

Neni 12 Ndërprerja e Kontratës nga Operatori Ekonomik

12.1 Operatori Ekonomik, pasi e ka paralajmëruar Autoritetin Kontraktues 14 ditë paraprakisht, mund ta ndërpresë kontratën nëse Autoriteti kontraktues: a) Nuk arrin t'i paguajë Operatorin Ekonomik shumën që duhet të paguhet brenda periudhës së saktësuar me kontratë; b) vazhdimisht nuk arrin t'i plotësojë obligimet e veta me kontratë; c) si rezultat i forcës madhore, Operatori Ekonomik nuk është në gjendje për

Kontratë e negociuar e Kuotimit të Çmimit: "Shtypja, paketimi dhe transporti i fletëvotimeve për Zgjedhjet e Jashtëzakonshme për Kryetar të Komunave Leposaviq, Zubin Potok, Zveçan dhe Mitrovicë e Veriut" me numër Identifikues të e-prokurimit 320-19-2653-1-3-5 dhe Nr. të brendshëm 320/19/009/135

të kryer një pjesë materiale të kontratës për më shumë se 180 ditë, për arsye që nuk janë specifikuar në kontratë ose që nuk i atribuohen të Operatorit Ekonomik.

Neni 13 Zgjidhja e mosmarrëveshjeve me procedurë gjyqësore

13.1 Nëse nuk mund të arrihet zgjidhje brenda 30 ditësh nga fillimi i procedurës miqësore për zgjidhje të mosmarrëveshjes, secila palë mund të kërkojë ose vendim nga gjyqi, ose vendim arbitrimi.





13.2 Çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të cilat mund të lindin gjatë ekzekutimit të kësaj kontrate dhe se nuk është e mundur të zgjidhet ndryshe ndërmjet palëve do të dorëzohet në [specifiko gjykatën kompetente] në pajtim me ligjin e Kosovës.

Neni 14 Komunikimi

14.1 Çdo komunikim me shkrim në lidhje me këtë Kontratë ndërmjet Autoritetit Kontraktues dhe Operatorit Ekonomik duhet jap Titullin e kontratës dhe numrin e identifikimit, dhe duhet të dërgohet me postë, faks, e-mail ose me dorë.

Për Autoritetin Kontraktues - SKQZ	
Emri dhe mbiemri:	Burim Ahmetaj
Pozita:	Menaxher i Projektit
Nr i telefonit:	044 612 044
Email adresa:	burim.ahmetaj@kqz-ks.org
Për Operatorin Ekonomik – CETIS D.D.	
Emri dhe mbiemri:	Illir Hoxha
Pozita:	Menaxher i Projektit
Nr i telefonit:	044 611 789
Email adresa:	ilir.hoxha@cetis.si

E hartuar në gjuhën Shqip në tri origjinale, dy origjinale për Autoritetin Kontraktues dhe një original për Operatorin Ekonomik.

Për Autoritetin Kontraktues		Për Operatorin Ekonomik	
Emri:	Visar Kastrati	Emri:	Roman Žnidarič
Pozita:	U.D. Udhëheqës i Njësisë së Prokurimit	Pozita:	Drejtor Ekzekutiv i Cetis D.D.
Nënshkrimi:		Nënshkrimi:	
Data:	10.05.2019	Data:	10.05.2019
Vula:		Vula:	

Kontratë e negociuar e Kuotimit të Çmimit: "Shtypja, paketimi dhe transporti i fletëvotimeve për Zgjedhjet e Jashtëzakonshme për Kryetar të Komunave Leposaviq, Zubin Potok, Zvečan dhe Mitrovicë e Veriut" me numër Identifikues të e-prokurimit 320-19-2653-1-3-5 dhe Nr. të brendshëm 320/19/009/135




Nr. i art.	Artikulli	Përshkrimi	Njësia	Sasia	Qmimi me TVSH per njesi	Totali i Qmimeve me TVSH
1	Fletëvotime	Fletëvotimi (Formati A4)	copë	58,000	0.088 €	5,104.00 €
2	Fletëvotime	Fletëvotimi (Formati A5)	copë	58,000	0.015 €	870.00 €
					Totali	5,974.00 €

Verejtej: OE I lejohet qe te vendosin ne cmimin per njesi me shum se dy shifra pas presjes dhjetore.

